

VENDIM
Nr.875, datë 22.12.2004

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT
TË RI NË QYTETIN E KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i ujësjellësit të ri në qytetin e Korçës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të ujësjellës sh.a.-së, Korçë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 750 m² tokë truall, e vlerësuar në shumën e përgjithshme 6 300 000 (gjashtë milionë e treqind mijë) lekë.
 4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 175 500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë dhe të përballohet nga ujësjellës sh.a.-ja, Korçë.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2004.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe ujësjellës sh.a.-ja, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTAT E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E UJËSJELLËSIT
TË RI TË QYTETIT TË KORÇËS**

Nr.	Emri Mbiemri	Sip. tokë truall m ²	Njësia lek m ²	Vlera lekë
1.	Klito Nikolla Fundo	750	8400	6 300 000
2.	Emil Nikolla Fundo			
3.	Elisaveta Nikolla Fundo			
	TOTALI			6 300 000

Gjithsej vlera totale e shpronësimit 6 300 000 lekë.